

LIGJ
Nr.8300, datë 12.3.1998

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8095, DATË 21.3.1996 “PËR SHËRBIMIN CIVIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, si dhe të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8095, datë 21.3.1996 “Për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

Neni 15 ndryshohet si vijon:

“Postet e strukturës organizative të shërbimit civil që do të zihen nga funksionarë politikë, paraqiten sipas shtojcës 1 të bashkëlidhur.”

Neni 2

Në nenin 25 të ligjit, paragrafi i parë, ndryshohet si vijon:

“Nëpunësit civilë ekzistues në shërbimin civil, të cilët punojnë në detyra që përfshihen nga ky ligj për një periudhë më të madhe se tre vjet para datës së krijimit të komisionit të shërbimit civil, fitojnë statusin e nëpunësit civil kur, me paraqitjen e kërkesës së tyre dhe shqyrtimit të përputhshmërisë së dosjes personale të nëpunësit civil me kriteret e postit të punës, marrin një certifikatë kualifikimi përmes një vendimi nga ana e komisionit të shërbimit civil.”

- Paragrafi i pestë ndryshohet si vijon:

“Kur nëpunësi, brenda 12 muajve nga data e krijimit të komisionit të shërbimit civil, nuk bën kërkesë pranë komisionit për të marrë certifikatën e kualifikimit ose kur komisioni nuk ia lëshon atij këtë certifikatë, atëherë nëpunësi nuk e fiton statusin e nëpunësit civil dhe:”.

Paragrafi i shtatë ndryshohet si vijon:

“Nëpunësit ekzistues në shërbimin civil, të cilët punojnë me detyra që përfshihen nga ky ligj për një periudhë më të vogël se 3 vjet para datës së krijimit të komisionit të shërbimit civil, fitojnë statusin e nëpunësit civil, kur i nënshtrohen një provimi të organizuar nga komisioni i shërbimit civil, në bashkëveprim me këshillin emërues, sipas kërkesave të përcaktuara prej tyre.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA NR.1

Lista e funksionarëve politikë që janë objekt i ligjit “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, si edhe institucionet përkatëse janë si më poshtë:

I. NË PRESIDENCË

1. Sekretari i Përgjithshëm.
2. Anëtarë të kabinetit të Presidentit të Republikës dhe anëtarët e kabinetit të sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës, ku hyjnë:
Shefi i kabinetit, këshilltarët, ndihmësat, zëdhënësat pranë kabineteve dhe sekretarët personalë.
3. Këshilltarët e Presidentit jashtë kabinetit.

II. NË KUVENDIN POPULLOR

1. Sekretari i Përgjithshëm.
2. Këshilltarët e Kryetarit të Kuvendit Popullor.
3. Anëtarët e kabineteve të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit: këshilltarët, ndihmësat, sekretarët personalë.
4. Shefi i Marrëdhënieve me Jashtë.
5. Zëdhënësat e Kuvendit Popullor.

III. NË KËSHILLIN E MINISTRAVE

1. Kryetari i Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave.
3. Ministër Shteti pranë Kryeministrit.
4. Ministër Shteti.
5. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.
6. Anëtarët e kabineteve të funksionarëve të mësipërm ku hyjnë:
shefat e kabineteve, këshilltarët, ndihmësat, zëdhënësat pranë kabineteve dhe sekretarët personal.

IV. NË MINISTRI

1. Ministër.
2. Sekretar Shteti.
3. Zëvendësministër.
4. Anëtarët e kabineteve të funksionarëve të mësipërm, të cilët kanë kabinete, ku hyjnë:
shefat e kabineteve, këshilltarët, ndihmësat, zëdhënësat pranë kabineteve dhe sekretarët personal.

V. NË KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT

1. Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.
2. Zëvendëskryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit.
3. Anëtarët e kabineteve të funksionarëve të mësipërm, të cilët kanë kabinete, ku hyjnë:
shefat e kabineteve, këshilltarët, ndihmësat, zëdhënësat pranë kabineteve dhe sekretarët personal.

VI. NË SEKRETARIATET E SHTETIT

1. Sekretari i Shtetit.
2. Anëtarët e kabinetit të funksionarit të mësipërm, ku hyjnë:
shefi i kabinetit, këshilltarët, ndihmësat, zëdhënësat pranë kabinetit dhe sekretarët personal.

VII. NË PREFEKTURA

1. Prefekti.
2. Sekretari i përgjithshëm i prefekturës.
3. Sekretari i prefektit.

VIII. NË BASHKI E KËSHILLAT E RRETHEVE

1. Sekretari i bashkisë.
2. Sekretari i kryetarit të bashkisë.
3. Sekretari i këshillit të rrethit.
4. Sekretari i kryetarit të këshillit të rrethit.

**Shpallur me dekretin nr.2015, datë 24.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**